



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1569/12 Prot.

Tiranë, më 20.06.2023

V E N D I M

Nr. 43 datë 20.06.2023

**“MIRATIMIN E SHLYERJES SË TARIFËS PËR REGJISTRIMIN E  
MODULEVE TË TRAJNIMEVE”**

Në mbështetje dhe në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH”, neni 49, të Statutit të UST-ës, në Udhëzimin Nr. 16 datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor”, në shkresën ASCAP nr. 685/3, datë 08.07.2022 “Njoftim”, në Vendimin e Bordit të RASH nr.4 datë 17.03.2022, “Për miratimin e tarifës së shërbimit Portali i trajnimeve të Qendrës RASH gjatë vitit 2022”, në shkresën nr. 1504 datë 02.06.2023, të Qendrës së Trajnimit të Vazhduar të UST-së “Kërkesë për miratimin e tarifës së rregjistrimit të moduleve të trajnimit”, të Vendimit të Rektorati nr. 54 datë 08.06.2023, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 64 datë 13.06.2023 “Miratimin e shlyerjes së tarifës për regjistrimin e moduleve të trajnimeve” Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 20 .06.2023

V E N D O S I :

1. Të miratojë pagesën e shlyerjes prej 500 Euro RASH për fashën 100-500 regjistrime për tu trajnuar në një vit, për rregjistrimin e moduleve të trajnimit.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të Universitetit të Sporteve të Tiranës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek trasparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

